



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Glllogoc

Zyra e Personelit

01Nr. 111 - 24642 dt. 08.07 /2020

Bazuar në nenin 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Komuna Glllogoc/Drenas, Zyra e Personelit shpall:

KONKURS PUBLIK ME MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

Për angazhim afatshkurter konform nenit 12 paragrafit 4, të Ligjit nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, (Marrëveshje për Shërbime të Veçanta).

Pozita: e vendit të punës:

koeficienti :

1. (Një) Inspektor të Mjedisit - DI

7

Detyrat e punës:

- Inspektimi i ujrave të zeza (kanalizimeve) sipas kërkesave, si dhe ndotësve të ajrit;
- Shqyrtimi i kërkesave të banorëve nga lëmia e mjedisit rreth ndotjes;
- Inspektimi i operatorve legal (gurëthyesve), si dhe marrja e masave ndaj kompanive që e shfrytëzojnë materialet guror në prona shoqërore pa pelqime nga MMPH-rë dhe KPMM;
- Merr pjesë në hartimet e planeve dhe Rregulloreve nga lëmia e Mjedisit;
- Marrja e masave për hyrje në system të menaxhimit të mbeturinave;
- Marrja e masave për ndotësit e mjedisit;
- Kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.

Qëllimi i vendit të punës : Mbikëqyrja e zbatimit dhe implemetimit të Ligjeve dhe Rregulloreve Komunale që kanë të bëjnë me këtë lëmi. Bashkëpunon me Drejtorin e Drejtorisë dhe njëherit kordinon punët në këtë sektor rreth kompetencave që kanë të bëjnë me mbrojtjen e Mjedisit. Nga kjo pozitë kërkohet të arrihet një mjedis i pastër konform legjislacionit si dhe shfrytëzimi i të gjithë mekanizmave të cilët kanë qasje në edukim për zhvillim të qëndrueshëm mjedisor.

Shkathtësitë e kërkuara: (kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë Universitare – Teknologji Ushqimore, Kimi, Mjedis,
- Njohja e kompjuterit,
- Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin,
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion,
- Njohuri të mira nga fusha e lëmisë ku punon dhe të ngjashme.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.04/L-077, Për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtuar e rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **08/07/2020 deri më 15/07/2020**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Kohëzgjatja e angazhimeve është 5.5 muaj.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës.

Aplikacionit i bashkangjiten kopjet dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vend pune, për të cilin konkurohet.



ZYRA E PERSONELIT